



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

INFORMACION MBI PROCEDURAT E RIVLERËSIMIT TË TESTIT

Të nderuar Maturantë!

Në zbatim të Rregullores së Maturës Shtetërore, ju rikujtojmë:

1. Maturanti/kandidati ka të drejtë të kërkojë kopjen e testit një ditë pas shpalljes së rezultateve paraprake të të gjitha provimeve të MSH. Rezultatet paraprake të provimeve të Maturës Shtetërore shpallen **jo më vonë se data 30 qershor**. Pra, vetëm pas shpalljes së rezultateve të të gjitha provimeve, maturanti/kandidati bën kërkesën për kopje të testit nëpërmjet portalit e-Albania. Ju mund të kërkonte kopjen e testit për një, dy, tre ose të katërta provimet e Maturës Shtetërore.
2. Aplikimi do të kryhet në portalin e-Albania, sipas afateve të përcaktuara nga QSHA. Ju duhet të identifikoheni si qytetar në portalin e-Albania dhe të zgjidhni shërbimin “Aplikim për kopje të testit të Maturës”. Aty duhet të plotësoni saktë të dhënat tuaja, duke specifikuar dhe provimin/provimet ku dëshironi kopjen e testit.
3. Pas trajtimit të kërkesës, QSHA brenda datës **4 korrik** do të dërgojë kopjen e testit për secilin maturant/kandidat që e ka kërkuar atë, në “Hapësira ime”, seksioni “Dokumentet e mia”, në llogarinë përkatëse të çdo maturanti/kandidati, në e-Albania.
4. Maturanti/kandidati, pasi është pajisur me fotokopjen e testit ka të drejtë ta paraqesë kërkesën për rivlerësim testi, në Komisionin Shkollor të Maturës Shtetërore (KSHMSH) ku është regjistruar si maturant/kandidat, **më datë 5 korrik 2024**.
5. KSHMSH mbledh të gjitha kërkesat për rivlerësim testi, të paraqitura nga maturantët/kandidatët.
6. Fotokopjet e testeve të paraqitura në KSHMSH shqyrtohen nga dy mësues lëndorë të përcaktuar nga KSHMSH.
7. Mësuesit shqyrtojnë kërkesat e paraqitura nga maturantët/kandidatët vetëm për pyetjet e ankimuara dhe vendosin nëse këto teste do t’i kalojnë për rivlerësim QSHA.
8. QSHA kryen procedurën e rivlerësimit të testeve, me të njëjtat rregulla e procedura si vlerësimi i testeve, duke i sekretuar me barkode testet që rivlerësohen.
9. QSHA kryen rivlerësimin e të gjithë testit. Pas rivlerësimit, vlerësimi përfundimtar i maturantit mund të jetë:
 - a) me të njëjtin rezultat;
 - b) duke iu ndryshuar rezultati me rritje pikësh;
 - c) duke iu ndryshuar rezultati me ulje pikësh;
10. Rezultatet përfundimtare të provimeve të maturës pas procesit të rivlerësimit shpallen jo më vonë se data **10 korrik 2024**.

Ju urojmë suksese!